



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.78

Prishtinë, më 14.5.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj, Ardian Kastrati, Adriana Matoshi dhe Vlora Dumoshi.

Munguan: Eliza Hoxha dhe Arjeta Fejza.

Pjesëmarrës tjerë: Arbërie Nagavci, ministre e MASHTI, Qerim Qerimi, rektor i UP-së Altin Sahiti, Blerim Saqipi, Azem Hajdari, Faton Berisha dhe Aliriza Arënliu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 30.4.2024;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.10/165, datë 12.10.2023 për miratimin e Statutit të ri të Universitetit Publik “Hasan Prishtina” në Prishtinë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-301 për ratifikimin e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg veterinar, farmacist dhe mami në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë të lirë të Evropës Qendrore;
5. Miratimi i Projektrezolutës për raportin vjetor të KKTK-së për vitin 2022;
6. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.4.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtura më 30.4.2024, miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.10/165, datë 12.10.2023 për miratimin e Statutit të ri të Universitetit Publik “Hasan Prishtina” në Prishtinë

Ardian Gola, tha se për të prezantuar konceptin e këtij draft Statuti sot kemi ministren, rektorin dhe shoqëruesit e kësaj përbërjeje në Komision. Statuti është proceduar në fund të tetorit dhe Komisioni e ka diskutuar si çështje idenë për të organizuar dëgjime publike me njësitë akademike në Universitetin e Prishtinës. Organizimi i dëgjimeve publike është dhënë me sinjalizimin që kanë bërë disa profesorë dhe një pjesë e stafit akademik, që nuk janë ndie mjaftueshëm të përfshirë në hartimin e këtij Statuti. Zyra ligjore e Kuvendit i ka dhënë të drejtë Komisionit, si për të organizuar dëgjime publike, ashtu edhe për të amendamentuar Statutin. Propozimi im ka qenë që të mos ndërhyjmë në pjesën akademike të Statutit, meqë është jokorrekte që pjesa politike të ndërhyjë në pjesën akademike, gjithsesi kam konsideruar që është shumë e nevojshme që të ndërhyhet në Statut për sa i përket nevojës për të eliminuar çfarëdo kundërshtie eventuale në mes Statutit dhe kornizës juridike të vendit, përfshirë Kushtetutën dhe Ligjin për arsimin e lartë. Dëgjimet publike janë mbajtur me 4 njësi akademike, Fakulteti filozofik, Fakulteti filologjik, Fakulteti i arteve dhe Fakulteti i shkencave matematiko natyrore, ku kemi marrë disa komente që do të ishte mirë të adresoheshin në versionin final.

Arbërie Nagavci, ministre MASHTI, tha se ky Statut po rishikohet pas 12 vjetëve. Rektori ka themeluar grupin punues që të përgatit draftin e statutit të ri, i njëjti është miratuar në senat me 31 korrik të vitit të kaluar, pas miratimit në Këshillin drejtues, është përcjellë në Ministri, ku është miratuar pa asnjë ndërhyrje, duke respektuar autonominë e plotë të Universitetit dhe duke pasur parasysh që në grupin punues ka pasur profesionistë dhe kanë marrë praktikën më të mira, duke respektuar plotësisht edhe akademinë e Universitetit të Prishtinës. Statut sjell një mori vendimesh e reformash, që do të ndikojnë direkt në cilësinë e punës në Universitetin e Prishtinës, jemi duke pritur që të fillojë një proces i unifikimit të statuteve të të gjitha Universiteteve të tjera publike sepse besojmë që kjo sjellë përmirësimin e punës në arsimin e lartë dhe një performancë më të mirë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij Statuti dhe nevojën emergjente në përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, unë ju ftoj që ta miratoni.

Qerim Qerimi, rektor, tha se do të përqendrohem tek procesi që kemi ndjekur për hartimin e një Statuti të ri, ka pasur një konsensus që Statuti të ndryshohet është e rëndësishme të theksohet se tema përmbajtësore, kriteret qendrore me të cilat Universiteti ka operuar dhe po operon janë përgjithësisht të mbështetura në një standard të krijuar në më tepër se dy dekada, prandaj në këtë drejtim, ideja ka qenë që duhet të reflektojmë mbi gjendjen ekzistuese mbi trendët dhe mbi aspiratat komplet legjitime të Universitetit, për të qenë i krahasueshëm dhe konkurrues me planin ndërkombëtar. Në kuptimin e procesit, kemi angazhuar disa ekspertë, kryesisht profesorë, stafi ynë akademik nga fusha të ndryshme që kanë bërë një analizë krejt të statuteve të tjera evropiane që kanë shërbyer si model për hartimet e statuteve të universitetit. Profesorë të Universitetit të

Prishtinës janë përqendruar kryesisht në identifikimin dhe ndryshimin që të përshtatim standardin i cili ka lëvizur qartazi për gjatë kohëve me standardin evropian dhe kanë gjeneruar një koncept dhe disa ide propozime për atë se çfarë do të ishte e nevojshme, në çfarë fryme dhe me çfarë efekti do të duhej të bëheshin ndryshimet. Kemi organizuar disa konsultime me dekanë të njësive akademike me Kolegjiunin e dekanëve, kemi pasur konsultime edhe me anëtarë të Këshillit Drejtues dhe me senatorë, dekanë të njësive kanë organizuar këshillime me stafet e tyre, kemi pranuar komente nga radhët e njësive akademike dhe me grupin punues kemi shqyrtuar të gjitha këto komente. Vlerësojmë që Statuti përfaqëson një standard të Universitetit për Universitetin dhe kërkojmë që sa i përket substancës të Statutit, të respektohet përcaktimi që Universiteti ka bërë për vetën e tij.

Ardian Kastrati, tha se do të flas në dy cilësi, edhe të profesorit edhe të deputetit, së pari do të paraqes qëndrimet që i ka Grupi Parlamentar i PDK-së, që ndryshimet të cilat janë bërë në Statutin e ri me i realizua pritjet që ka Universiteti për avancimin e tij në arenën ndërkombëtare. Sido që të jetë, për disa reagime se kush do të jetë përfaqësues i shoqërisë civile me emër të përveçëm s'jam i interesuar por ka reagime të tjera për emrin. Si Grup Parlamentar i PDK-së nuk do të votojmë dhe jemi kundër me ndërrua emrin e Universitetit "Hasan Prishtina". I kuptoj të gjitha çështjet të natyrës teknike nëpër platforma është dashur që në Ligjin për arsimin e lartë me propozua me inkorporua Universitetin e Prishtinës, përkohësisht të vendosur në veriun e Mitrovicës në kuadër të institucioneve tona, dhe me ja ndërrua emrin atij universiteti, atëherë do të ishte në rregull dhe lirohemi nga kjo barrë e përgjegjësi. Sa i përket ndryshimeve në nenet e caktuara të Statutit që propozohen do të jem shumë konstruktiv.

Arbërie Nagavci, tha se Ligji për arsimin e lartë është proceduar dhe i kisha inkurajua që me u angazhua që me marrë përkrahje edhe në Kuvend, edhe pse të jeni në dijeni që ligji do të përballet me sfida të veçanta sepse është legjislacion i cili e ka të domosdoshme votën e deputetëve serbë.

Jahja Kokaj, tha se duke e respektuar personalitetin tuaj dhe seriozitetin jap konstatimin që ky Statut është mjaftë serioz dhe se me kënaqësi do ta votoja dhe duke theksuar që kjo ministri dhe ky komision është i interesuar për ngritjen e cilësisë. Ai dhe dy propozime, një ka të bëjë me mundësinë e futjes së një komisioni në nivel të departamentit që ka të bëjë me kurset dhe kurrikulën, që përmes asaj në mënyrë profesionale të përcillen rrjedhat e zhvillimit ekonomik të shtetit dhe zhvillimet e teknologjisë dhe shkencës botërore, tjetra lidhet me etiken, konkretisht për plagjiaturën në Amerikë në 52 shtetet, nuk mundë të jetë në mësim ai që hetohet që ka plagjiaturë e cila është trishtuese, jo vetëm në aspektin pedagogjik dhe moral, por në perspektivën e të ardhmes së një kombi, prandaj konsideroj që duhet të jetë shumë rigorozë në qoftë se do të verifikohet që ka plagjiaturë, personi i atillë mos të ketë shansë. Brenda statutit mendoj që situata kur kemi ide gjeniale të përparojnë, përndryshe të gjithë duhet ti nënshtrohen 4 vjeçarit që të inkubohet dhe fatmirësisht që keni thënë që profesorë asistent duhet ta ketë një punim në Scopus, sepse kemi akademik që nuk kanë asnjë punim në Scopus.

Enis Kervan, tha se kam marrë pjesë në disa dëgjime publike dhe kam pasur rastin të dëgjoj edhe pritjet e profesorëve nga Universiteti dhe propozimet e tyre kanë qenë me vend. Unë përfaqësoj Grupin parlamentar multi-etnik, por edhe komunitetet jo serbe dhe joshumicë në Kuvend dhe kemi vullnetin ta përkrahim këtë Statut si grup parlamentar, por me disa korrigjime. Statuti në nenin 6 flet për mundësitë të barabarta që universiteti respekton parimet kushtetuese dhe mosdiskriminimin e ofrimit të barabartë dhe pika 2 thotë, se universiteti obligohet të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë, pa asnjë lloj diskriminimi në bazë gjinie, race, përkatësi

kombëtare etnike, Statuti neni 74 paragrafi 4, kur flet për gjuhët e diplomave, thotë se e diploma dhe shtojca e diplomës rishkruhet në gjuhën shqipe dhe atë angleze, ku bie në kundërshtim me të drejtat e komuniteteve me Kushtetutën, e cila na i ofron të drejtat e gjuhës me Ligjin për gjuhët e Republikës së Kosovës, me Ligjin për arsimin e lartë. Mendoj që këtu duhet të shtohet edhe në gjuhët e arsimit edhe në gjuhët tjera. Neni 74 flet për diplomatat doktoratat, mendoj që sot nëse nuk ka program për diplomatat doktorata në gjuhët turke, apo boshnjake, mund të kemi nesër. Pjesëtarë të komuniteteve kanë të drejtë me kërkua që diploma edhe në gjuhët e tyre amtare, unë kam përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës dhe kam kërkuar diplomë në gjuhën turke. Ne e mbështetim fuqishëm dhe me këtë plotësim ndryshim, ne mund ta përkrahim këtë Statut.

Albena Reshitaj, tha se po flasim për Statutin e ri të Universitetit të Prishtinës për angazhimin dhe punën që është bërë deri tani e falënderoj Këshillin Drejtues, Rektoratin. Si mësimdhënëse kam lexuar çdo nen të propozuar të këtij Statuti dhe jam ndalur tek pjesa e specifikave të Fakultetit të Mjekësisë që është njëra nga njësitë më të mëdha të Universitetit të Prishtinës, përmban 40 për qind të njësisve akademike në nenin 162, specifikohet pjesa që do të votohen në Senat me Rregullore të veçanta, angazhimi dhe bashkëpunimi i Fakultetit të mjekësisë me SHSKUK-në, një nevojë imediate për një seriozitet bashkëpunimi të duhur, në mes të këtyre dy institucioneve sepse ka pasur probleme të herëpashershme dhe mbi të gjitha këto ndryshime që janë vendosur në këtë Statut të është shumë e rëndësishme të fokusohemi edhe në implementim dhe respektimin e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Brenda Këshillit Etik të Universitetit të Prishtinës, kemi nevojë të analizojmë se a po punohet si duhet, sepse një mësimdhënësi i kërkohet të avancoj profesionalisht që jam e pajtimit për ta ngritë edhe cilësinë arsimit, por që a po i krijoni mundësi që të ndihet i sigurt në vendin e punës, prandaj, konsideroj që përtej kësaj, të gjithë ne duhet ta bëjmë, por që edhe studentët duhet të ndjehen të sigurt në Universitetin e Prishtinës dhe këtë mund ta bëni ju, duke vepruar vetëm në bazë të rregulloreve dhe përgjegjësisë që ka Universiteti i Prishtinës. Si Komision e kemi të drejtën ta përkrahim apo mos ta përkrahim, kemi mundësi që t'i diskutojmë vërejtjet tona për ta votuar këtë Statut të ri, andaj kërkoj respektimin e rregulloreve dhe mbi të gjitha krijimin e një atmosfere pune e prosperiteti brenda Universitetit të Prishtinës.

Vlora Dumoshi, tha se po diskutojmë një temë shumë të rëndësishme, ku bëhet fjalë për Statutin e Universitetit të Prishtinës. Çdo ndryshim është i mirëseardhur, kur reflekton mbi punën dhe rregulloret, sidomos të Universitetit në përgjithësi. Interesimi i stafit akademik në takime ka qenë mjaft i madh ku ka pasur edhe kritika. Rektori tha, që ka mbajtur takime me dekanë, por po më intereson a kanë marrë pjesë edhe profesorët, apo ka qenë vetëm grupi i përbërë nga dekanët dhe senatorët. Nuk dëgjova ndonjë ndryshim konkret që është bërë në këtë Statut. Në Statutin e kaluar është kërkuar një punim, kurse tani kërkohen dy punime shkencore, ky është ndryshim cilësor. Ne si deputetë kemi pranuar shumë kërkesa, ankesa të ndryshme për nenin 2, ku është paraparë heqja e emrit Hasan Prishtina nga Universiteti i Prishtinës, ku dihet se 3000 studentë kanë nënshkruar një peticion andaj kërkoj versionin e tuaj të këtij propozimi sepse kemi Universitetin e Pejës, “Haxhi Zeka”, “Isa Boletini”, në Mitrovicë, e kemi “Fehmi Agani”, “Kadri Zeka”, me figura shumë të mëdha kombëtare. Me këtë vendim, me këtë propozim a keni mendua edhe për këto universitetet tjera, andaj kërkoj nga rektori që ta jep versionin e tij me universitetet tjera që kanë emra të figurave të mëdha kombëtare, besoj që ju sigurisht i keni shikuar edhe modalitetet e tjera teknike ndërkombëtare, por është për keqardhje që ne si shoqëri hapim rrugë me i largu emrat e heronjve kombëtarë.

Arjeta Rexhepi, tha se më vjen mirë që kemi përpara një statut të Universitetit të Prishtinës, i cili pas 12 viteve po rishikohet dhe po bëhen disa ndryshime. Shihet qartë se çka është analizua dhe që ka ndryshime konkrete, sidomos tek avancimi i kriterëve për zgjedhjen e stafit akademik. Është me rëndësi që si Komision të diskutojmë dhe të ecim përpara edhe me Statutin e ri, gjithashtu respektojmë edhe autonominë e Universitetit të Prishtinës, që ky statut sa më shpejtë të shkojë në Kuvend.

Arbërie Nagavci, tha se në aspektin përmbajtjesor, ky meaxhment dhe aktualisht Universiteti i Prishtinës po i adreson më shumë se kurrë të gjitha rastet, të cilat e meritojnë të trajtohen. Mund të ketë raste individuale, unë kam biseduar me rektorin që të adresojnë secilën çështje, duke filluar nga shqetësimet e studentëve, deri tek mbajta e pozitave të paligjshme dhe çështje të tjera.

Vlora Dumoshi, pyeti ministren Nagavci, ministre, a jeni ju për ndërrimin e emrit të Universitetit “Hasan Prishtina”?

Arbërie Nagavci, tha se e respektoj plotësisht draftin e Statutit të cilin e ka sjellë Universiteti, duke pasur parasysh politikën e Universitetit, duhet të jenë të kujdesshëm e të përgjegjshëm që ndikon edhe në performancën e universitetit edhe në rangimet ndërkombëtare dhe në pikën e emrit, universiteti ka bërë zgjidhjen më të mirë të mundshme.

Qerim Qerimi, tha pyetjet që po adresoni, sa i përket mundësisë që të ketë një komision përbrenda departamenteve, kemi një trup të tillë që quhet Komisioni i Studimeve në kuadër të fakulteteve, është, jo në departamente, por që ka sigurisht përfshirje edhe të përfaqësuesve që vijnë nga departamente të ndryshme, që ka rol të rishikojë kurrikulën dhe lëndët. Sa i përket çështjes së plagjiaturës, jemi kujdesur që statuti të reflektojë përmbajtje korrekte dhe të përputhshme me përcaktimet që kanë universitetet ndërkombëtare. Pjesën që lidhet me Këshillin e etikës, kemi kërkuar dhe kemi përfituar nga Qeveria Amerikane një këshilltar, i cili do të mbështes Këshillin e Etikës, profesor i etikës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që të na mbështesë që të rishikojmë në tërësi nenet që i kemi në fuqi. Sa i përket çështjes së specifikave të Fakultetit të Mjekësisë, jemi mbështet në rekomandimet që kanë ardhur nga ai fakultet dhe kemi reflektuar në statut sepse kemi vlerësuar që ata kanë thirrje kompetencë dhe dije më të specializuar, sa i përket nevojave dhe specifikave të asaj njësie akademike.

Pyetjes së parë të deputetes Dumoshi, kemi mbajtur takime me dekanë për procesin që ka ndjekur brenda njësive akademike, ne kemi 14 njësi akademike, 14 dekanë, secili fakultet ka 3 ose më shumë prodekanë. Ideja është që këta të diskutojnë çështje brenda këshillave të fakulteteve dhe të na sjellin propozimet, njësoj kemi vepruar edhe në këtë rast, ku dekanët mbledhin stafin e tyre marrin komentet dhe i përcjellin tek ne. Kemi pasur kontakt gjithashtu edhe me studentët, ku ata e kanë pasur përfaqësuesin e tyre në grup punues dhe ne e kemi pasur mbështetjen e plotë të Parlamentit studentor për draftin e statutit.

Sa i përket specifikës së emrit, e vërtetë që ka pasur një petition të një numri të konsiderueshëm të studentëve, që nuk kemi bërë ndonjë verifikim të përmbajtjes emrave nënshkrimeve sepse nuk e kemi parë të nevojshëm, por i kemi dëgjuar dhe i kemi vlerësuar me shume kujdes shqetësimet, sigurisht ka pasur propozime nga më të ndryshmet, që janë debatuar nga rikthimi origjinal emrit deri tek një seri opsionesh tjera, por ajo se për çfarë ka pasur konsensus brenda Universitetit kemi vlerësuar se siguron një baraspeshë, kjo zgjidhje që kemi propozuar në draft statut. Mendoj që ka një dallim thelbësor në mes Universitetit të Prishtinës, me ato që ju i cekët, sepse ato janë themeluar me emrat që kanë, për dallim nga ky. Ne kemi një ligj me të cilin është themeluar Universiteti i Prishtinës, pra nuk është themeluar me statut dhe në të vërtetë edhe Kushtetuta e

Republikës së Kosovës ka disa dispozita tranzitore, që njeh vazhdimin e vlefshmërisë të akteve juridike që kanë qenë në fuqi më përpara, ne nuk kemi gjetur që ka pasur një ligj të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili e shfuqizon Ligjin e Kuvendit të Kosovës për themelimin e Universitetit të Prishtinës dhe emri me të cilin me ligj është themeluar është Universiteti i Prishtinës, ky emër i është vënë në vitin 2012.

Arbërie Nagavci, tha se në lidhje me adresimin për respektimin e të drejtave joshumicë, siç mund të shihni nga neni 74, që ka të bëjë me diplomat, pika 2, përcakton që përmbajta e diplomave dhe të gjitha këto përcaktohen me udhëzim administrativ që nxirren nga ana e ministrisë dhe ne si ministri do ta adresojmë më udhëzim administrativ secilin lëshim që mund të rrjedhë nga statuti.

Albena Reshitaj, tha se ka një lloj paradoksi mes asaj që i ofrohet universitetit si ndihmë financiare nga shteti dhe ambicieve për ta ngritë cilësinë e arsimit për shkak se në Statut vërehen disa kërkesa të arsyeshme dhe gjithmonë ndryshimet e mëdha janë të dhimbshme, për ata që janë mësua me komoditet me qëndrua edhe në pozicione të caktuara. Tek pjesa e kërkesave kërkohet përvojë për udhëheqje të projekteve financiare, tek pjesa e profesorit të rregullt, pika 1.2.5, kërkohet që të jesh menaxher i një projekti me financim të jashtëm për universitetin. Universiteti i Prishtinës në Buxhetin për vitin 2024, ka kërkuar buxhet shtesë, pikërisht për këtë pjesë që ka qenë interesi që me ngritë përkrahjen financiare për hulumtues dhe mësime, por edhe për hulumtime për studentë të doktoratës, a keni mendua t’ju krijojmë mundësi që ata të avancohen sepse kemi mësime që janë të interesuar për me ngritë cilësinë, duke u avancua dhe çështja tjetër për ata që janë në vitin e fundit të avancuar, a do të vlejë statuti i ri apo ai i vjetri, sepse tek pjesa e avancimeve ka ndryshime dhe a do të kenë hapësirë dhe mundësi ata, apo duhet të presin edhe 4 vjet të tjera.

Ardian Gola, tha se duhet ta ngre një shqetësim të përgjithshëm lidhur me trajektoren që ka marrë zhvillimi i universitetit, sidomos prej vitit 2013, që kishim një largim të një rektori, para kryerjes së mandatit, traumë e cila është shkaktuar nga një abuzim jo i vogël me diskrecionin akademik. Gjatë kësaj dekade, shihet një kalim nga një pozicion i caktuar i ndërgjegjes së korruptuar akademike drejt një ndërgjegje të korruptuar në njëfarë mënyre në format të ri. Sa i përket rritjes së kërkesave për avancime akademike, jodomosdoshmërisht do ti konsideroja si cilësore, sidomos për faktin që nën zhvillimet e reja teknologjike është kompromentuar edhe procesi i hartimit të punimeve shkencore, kontraktimi të hartimit të punimeve, kontraktime të publikimeve të punimeve dhe këto probleme serioze për sa i përket nivelit akademik nuk janë adresuar, është tejet e vështirë edhe me u adresua, e dyta ka një problem kronik në mënyrën se si po i qasemi problemeve të arsimit të lartë, ajo është duke e përfshi edhe në masë të caktuar politikat aktuale prej menaxhmentit të UP-së e më lartë, e ajo është “one size fits all”, është problem që e kam paraqitur në vazhdimësi është mungesa e dallimit konceptual ndërmjet “equality and equity”, problem kronik që nuk po zgjidhet. Sa i përket kësaj jemi totalisht të padijshëm në raport me specifikat e fushave dhe nëse nuk i marrim parasysh specifikat e fushave, ne përfundojmë në pabarazi e qartësi i këtyre koncepteve është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Në trajtimin gjinor në këtë statut kemi kërkuar që medoemos t’i jepet një gruaje përparësi në raste kur ata dhe ato janë të barabarta në poentim, kjo është pabarazi, për shkak se në 4 njësi akademike, p.sh. arkitektura janë 17 gra dhe 5 burra, tek edukimi janë 30 burra dhe 37 gra, filologjiku i ka 37 burra 50 gra, mjekësia ka 141 burra 256 gra, në këto njësi akademike kur kandidojnë dy kandidatë me poena të njëjtë, një burrë dhe një grua, duhet ti jepet përparësi medoemos me këtë Statut një gruaje dhe automatikisht ti vazhdon me disavantazhu burrin me këtë strukturë, ky nen do të duhej me marrë parasysh proporcionalitetin

sepse barazia nëse nuk e konkretizon si barazi është shume problematike dhe përfundon në një raport diskriminimi gjinor. Për profesor ordinar kërkohen të paktën 4 punime prej thirrjes së fundit kjo, që i bien një punim në vit , hulumtuesit shkencor i cili është i dizajnuar për atë punë i kërkohen 2 punime brenda vitit, profesori ndërkohë ka punë me studentë, ligjërata, konsultime, mbajtja e provimeve, kontrollimi i tyre dhe ky po ka vetëm një punim ma pak sesa hulumtuesi, këtu dikujt i kërkohet pak ose dikujt është duke iu kërkua jashtëzakonisht shumë. Ka probleme edhe me gjuhën juridike, por diku thuhet që prorektorët zgjidhen diku që emërohen shkakton njëfarë problemi të brendshëm, tek studimet post doktrate, çfarë titulli merr me vendimet post doktoratë, a ka diku në botë studim post doktori, e di që ka kërkim post doktori, hulumtim post doktori, por studim post doktori, as nuk kërkohet në kornizën e Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisioni me pesë 5 vota për, një 1 abstenim dhe asnjë kundër, vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Statuti i ri i Universitetit të Prishtinës''Hasan Prishtina''në Prishtinë.

4.Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-301 për ratifikimin e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg veterinar, farmacist dhe mami në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë të lirë të Evropës Qendrore;

Ardian Gola, tha se ministrja Nagavci do ta prezantojë këtë projektligj.

Arbërie Nagavci, tha se Projektligji nr.08/L-301 për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermierë, kirurgë veterinarë, farmacistë dhe mami është në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore. Projektligji përcakton rregullat për njohjen e dëshmive të kualifikimeve formale, bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda palëve për qasje dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, andaj marrë parasysht rëndësinë e këtij rekomandon miratimin e tij

Komisioni me gjashtë (6) vota për, asnjë kundër, vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr.08/L-301 për Ratifikimin e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermierë, kirurgë veterinarë, farmacistë dhe mami në kontekstin e Marrëveshjes së tregtisë të lirë të Evropës Qendrore.

5. Miratimi i Projektrezolutës për raportin vjetor të KKTK-së për vitin 2022

Ardian Gola, tha se Komisioni në bazë të nenit 98 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 43 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive, në mbledhjen e mbajtur më 14.5.2024, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022. Ky raport paraqet një pasqyrë të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022 dhe rekomandimet e dala nga Komisioni për vitin 2023, në kuadër të reformës në sektorin trashëgimisë për të marrë masat e nevojshme për trajtim të pavarur dhe profesional, në përputhje më legjislacionin.

Komisioni me gjashtë (6) vota për, asnjë kundër, vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektrezoluta në lidhje me Raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore të punës për vitin 2022.

7. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 13 40

E përgatiti
Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,
Kryetar i Komisionit